



për
BASHKIMIN EVROPIAN



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INTEGRIMIT



për
BASHKIMIN EVROPIAN

Ministria e Integritit
Tiranë, 2007



*Përgatiti: **Klementin Mile**
Ministria e Integrit*

*Ky botim u mundësua nga
Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë*

PËRMBAJTJA

1. Kur u përdor për herë të parë termi “Evropë”?.....	4
2. Cilat ishin çështjet kryesore që duhet të trajtonin evropianët pas Luftës së Dytë Botërore?.....	5
3. Cili ishte kontributi i personaliteteve që njihen si “baballarët themelues” të Bashkimit Evropian, Jean Monnet (Zhan Mone) dhe Robert Schuman (Robert Shuman)?.....	7
4. Kur lindi Bashkimi Evropian?.....	12
5. Cilat janë tri shtyllat mbi të cilat ngrihet Bashkimi Evropian?.....	13
6. Kush e mbron interesin e përbashkët në Bashkimin Evropian?.....	17
7. Kush e përfaqëson zërin e shteteve anëtare të BE-së?	20
8. Si përfaqësohen qytetarët në Bashkimin Evropian?	24
9. Kush garanton paprekshmërinë e rregullave të “lojës” në BE?	28
10. Çfarë është integrimi evropian?.....	30
11. Çfarë është Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit?	32
12. Si është ndërtuar Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit?	34
13. Kur mund të anëtarësohet Shqipëria në Bashkimin Evropian?.....	38
14. Cilat janë sfidat që duhet të përballojë Shqipëria në kuadër të procesit të integritimit evropian?.....	39
15. Si mund të shpjegohet integrimi evropian?	44

1

KUR U PËRDOR PËR HERË TË PARË TERMI “EVROPË” ?

Historia e Evropës dhe historia e Bashkimit Evropian nuk janë e njëjta gjë, edhe pse ka shumë pika takimi në momente të ndryshme historike. Termi “Bashkim Evropian” i përket shekullit XX, ndërkohë që termi “Evropë” daton shumë më herët. Termi “Evropë” u përdor për herë të parë gjatë civilizimit grek, por në dy kontekste: njëri mitologjik dhe tjetri gjeografik. Prej etimologjisë së këtij termi mund të ngrihen shumë hipoteza, por megjithatë fjala greke *eurus* do të thotë *e gjerë*, duke e lidhur në këtë mënyrë Evropën me hapësira të gjera territoriale.

Në aspektin mitologjik Evropa konsiderohej si një femër shumë e bukur, e gjatë dhe me sy të mëdhenj. Gjithashtu Afrikës, në atë kohë i referoheshin shpesh me emrin Libia. Siç duket qartë, emrat e kontinenteve që njiheshin atëherë (Evropa, Azia, Afrika) në të gjitha versionet janë femërore. Kjo tendencë ka rezistuar deri në ditët tona, madje jo vetëm në lidhje me emrat e kontinenteve, por edhe të shteteve përbërëse të tyre.




Hartë e kontinentit evropian në periudhën antike

Nga ana tjetër, në aspektin gjeografik, në lashtësi Evropa shihej si një territor i ndarë nga dy kontinentet e tjera: Azia dhe Afrika. Evropa konceptohej si territor i kufizuar në veri nga Deti i Veriut dhe në lindje nga Ngushtica e Bosforit. Ky ishte konteksti mitologjiko – gjeografik i “Evropës” përgjatë civilizimit grek.

2

CILAT ISHIN ÇËSHTJET KRYESORE QË DUHET TË TRAJTONIN EVROPIANËT PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE?

Lufta e Dytë Botërore ishte më e rënda për njerëzimin përse i përket dëmeve materiale dhe në njerëz. Edhe pse konflikti pati një dimension global më të theksuar se në Luftën e Parë Botërore, viktima kryesore e këtij konfrontimi u bë Evropa. Numri i përgjithshëm i viktimave arriti në thuajse 40 milionë, prej të cilëve më shumë se gjysma ishin civilë. Pas internimeve dhe dëbimeve që ndodhën gjatë luftës, në vitin 1945 kishte rreth 20 milionë njerëz që pritnin të riatdhesoheshin. Persekutimet e paprecedenta raciale, fetare e politike dhe internimet masive drejt kampeve të punës dhe atyre të përqendrimit kishin shkaktuar shumë urrejtje ndërmjet popujve evropianë. Zbulimi i varreve masive në kampet e përqendrimit u dha një goditje të rëndë bazave shpirtërore dhe morale të qytetërimit perëndimor. Gjermanët ishin përfshirë nga ndjenja e fajit, e cila u bë shkak për një debat etik intensiv, por që rezultoi vetëm në shtimin e rrëmujës së përgjithshme që mbizotëronte tek kombi i mundur gjerman.



Varfëria që mbizotëronte në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore

Evropa ishte e shkatërruar dhe në konfuzion të plotë: fabrikat dhe rrugët ishin të shkatërruara, tregëtia tradicionale e zhvendosur, bujqësia e rrënuar, dhe ndërkohë mungonin lëndët e para dhe ushqimet. Lufta po zgjatej prej spastrimeve dhe zgjidhjes së llogarive të vjetra, që edhe një herë tjetër po krijonte ndasi në vendet e çliruara. Pajtimi dukej shumë i

vështirë. Dukej e pamundur që dikur armiqtë e djeshëm të mund të bashkoheshin në një organizim të përbashkët.

Popujt evropianë u gjendën para tri çështjeve. E para ishte ekonomike: Si mund të riparoheshin dëmet materiale dhe të ringrihej aktiviteti ekonomik në kontinentin e vjetër? Çështja e dytë ishte politike: Si mund të parandalohej rikthimi i konfliktit në Evropë? E treta ishte kulturore: Si mund të sigurohej mbijetesa dhe rilindja e qytetërimit evropian në kuadër të kërcënimeve në rritje, të cilat dukeshin se mishëroheshin në konfliktin ideologjik dhe konfrontimin ndërmjet blloqeve fituese të luftës, bllokut amerikan dhe atij sovjetik?

3

CILI ISHTE KONTRIBUTI I PERSONALITETEVE QË NJIHEN SI “BABALLARËT THEMELUES” TË BASHKIMIT EVROPIAN, JEAN MONNET (ZHAN MONE) DHE ROBERT SCHUMAN (ROBERT SHUMAN)?

Për shumë evropianë kërcënimet më të mëdha për paqen dhe sigurinë vinin prej nacionalizmit dhe shtetit kombëtar, ndërkohë që të dy u diskredituan prej luftës. Gjermania ishte problemi kryesor – argumentohej se paqja ishte e pamundur në rast se Gjermania nuk mund të frenohej dhe fuqia e saj të përdorej për qëllime konstruktive. Kështu që ekonomia dhe



Baballarët themelues të Bashkimit Evropian. Në të majtë Jean Monnet, në të djathtë Robert Schuman

sistemi politik gjerman do të duhej të rindërtohej në mënyrë të tillë që të mos kërcënohej siguria e Evropës.

Ndërkohë, konflikti në rritje ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik krijoi tek evropianët shqetësimin se mos bëheshin gurë shahu në Luftën e Ftohtë ndërmjet dy blloqeve. Ekzistonte nevoja për ta mbrojtur Evropën Perëndimore prej rrezikut sovjetik, por ndihej qartë shqetësimi se deri ku mund të arrinte bashkëpunimi me Amerikën dhe se deri në ç’pikë mund të varej Evropa prej

mbrojtjes amerikane. Ndoshta do të ishte më mirë që Evropa të kujdesej vetë për sigurinë e saj. Por kjo kërkonte unitet dhe synime të përbashkëta në një nivel shumë më të lartë se ai që Evropa kishte mundur të arrinte ndonjëherë.

Grupet kombëtare pro-evropiane vendosën të organizonin një konferencë që synonte të bënte publik shkaku e unitetit rajonal. Kongresi i Evropës i mbajtur në Hagë në Maj 1948 u ndoq prej delegatëve të 16 shteteve evropiane dhe vëzhguesve nga Shtetet e Bashkuara dhe Kanadaja. Aty u diskutuan shumë ide ambicioze, por rezultati konkret i kongresit ishte ideja për krijimin e Këshillit të Evropës. Ky i fundit u zyrtarizua një vit më pas me nënshkrimin në Londër të një statuti prej 10 shtetesh evropiane. Në statut u theksua nevoja për një bashkim më të ngushtë ndërmjet vendeve evropiane që e dëshironin këtë dhe shpalli se objektivat e Këshillit përfshinin veprimin e përbashkët për çështjet ekonomike, sociale, kulturore, shkencore, ligjore dhe administrative, por jo për çështjet e mbrojtjes. Megjithatë, edhe pse Këshilli i Evropës u zgjerua duke përfshirë më shumë anëtarë, ai nuk u bë ndonjëherë më shumë se një organizatë e dobët ndër-qeveritare. Këshilli i Evropës kontribuoi në përmirësimin e të drejtave të njeriut, çështjeve kulturore dhe në një nivel të kufizuar në bashkëpunimin ekonomik, por nuk ishte institucioni që dëshironin federalistët.

Ndërmjet atyre që kërkonin diçka më thelbësore në lidhje me integrimin rajonal ishin biznesmeni francez Jean Monnet dhe ministri i jashtëm francez Robert Schuman. Ata e kuptuan se duheshin ndërmarrë hapa praktikë që shtriheshin përtej deklaratave të përgjithshme të organizatave të tilla si Këshilli i Evropës dhe ranë dakord ndërmjet tyre se pikënisja logjike duhet të ishte zgjidhja e problemit të përhershëm të marrëdhënieve franko-gjermane. Në vitin 1950 shumë vetë e kishin të qartë se Gjermania Perëndimore duhet të lejohej të rindërtonte industrinë e saj, në mënyrë që të mund të luante një rol të dobishëm në aleancën perëndimore. Një mënyrë për ta bërë këtë, por nga ana tjetër të mos lejohej që Gjermania të shndërrohej në kërcënim për vendet fqinj, ishte ideja që Gjermania të rindërtohej në kuadër të një organizate mbi-kombëtare, e cila do ta lidhte dhe përfshinte Gjermaninë në një proces më të gjerë rindërtimi, atë evropian. Duke kërkuar

një pikënisje domethënëse, por jo shumë ambicioze, Monnet u fokusua tek industrinë e qymyrit dhe çelikut, të cilat ofronin një potencial të madh për një organizim të përbashkët evropian për disa arsye:

- Qymyri dhe çeliku ishin bazat mbi të cilat ngrihej industria, ndërkohë që industria e çelikut kishte tendencën e krijimit të karteleve. Bashkëpunimi do të eliminonte shpërdorimet dhe duplikimet, do të shkatërronte kartelet, do ta bënte më eficient dhe konkurrues prodhimin e qymyrit dhe çelikut, dhe do të stimulonte zhvillimin industrial.
- Për shkak se industrinë e rënda të Ruhrit (krahinë në Gjermani) kishin shërbyer si bazë e fuqisë gjermane dhe Franca e Gjermania kishin luftuar më parë për rezervat e qymyrit në Alsace-Lorraine, krijimi i një industrie mbi-kombëtare qymyri dhe çeliku do ta frenonte fuqinë gjermane.
- Integrimi i qymyrit dhe çelikut do të siguronte që Gjermania të ishte partner i besueshëm në tregëtinë me pjesën tjetër të Evropës, duke mundësuar njëherazi rindërtimin e Gjermanisë dhe duke fashitur frikën e Francës nga dominimi industrial gjerman.

Monnet e kuptoi se në rast se Franca nuk do të vepronte shpejt, Shtetet e Bashkuara do të bëheshin fokusi i një aleance të re transatlantike dhe kundër-sovjetike, që rritja ekonomike dhe ushtarake gjermane nuk do të mund të kontrollohej dhe që Franca do të eklipsohej, pra do ta humbiste pozicionin e saj të rëndësishëm në arenën ndërkombëtare. Monnet propozoi krijimin e një institucioni të pavarur prej qeverive kombëtare: mbi-kombëtar dhe jo ndër-qeveritar.

Pas diskutimeve me Monnet dhe kancelarin gjermano-perëndimor Konrad Adenauer, Robert Schuman i ngriti këto ide në një tjetër nivel në Maj 1950, gjatë një konference shtypi. Në atë që më vonë u quajt Deklarata e Schuman-it, ai argumentoi se Evropa nuk do të bashkohej menjëherë ose sipas një plani të vetëm, por hap pas hapi dhe nëpërmjet arritjeve konkrete. Kjo do të kërkonte eliminimin e armiqësisë ndërmjet

Francës dhe Gjermanisë, kështu që Schuman propozoi që prodhimi francez dhe gjerman i qymyrit dhe çelikut të vendosej nën një Autoritet të Lartë të përbashkët, në kuadër të një organizate ku mund të bënin pjesë edhe vende të tjera evropiane. Ky do të ishte hapi i parë drejt një Evrope federale dhe do ta bënte luftën ndërmjet Francës dhe Gjermanisë jo thjesht të paimagjinueshme, por edhe të pamundur materialisht.

Propozimi ishte revolucionar, për arsyen që Franca po ofronte të sakrifikonte pjesë të sovranitetit të vet kombëtar për hir të ndërtimit të një autoriteti mbi-kombëtar, që mund t'i jepte fund rivalitetit të vjetër franko-gjerman dhe të ndihmonte në ndërtimin e paqeje të re evropiane. Po të kujtojmë Luftën e Parë Botërore, gjatë së cilës konflikti franko-gjerman u zgjidh me fitoren e Francës, kjo e fundit, pas mbarimit të kësaj lufte thjesht u kënaq me rikthimin e territoreve franceze që ishin pushtuar nga Gjermania dhe me përfitime të tjera monetare, por në asnjë mënyrë nuk u ngrit ndonjë ide për sakrifikim të sovranitetit francez. Anëtarësia në Autoritetin e Lartë iu ofrua të gjitha vendeve të Evropës perëndimore, por vetëm katër prej tyre pranuan të marrin pjesë: Italia, e cila dëshironte të respektohej si dhe stabilitet ekonomik dhe politik, vendet e Beneluksit (Hollanda, Belgjika dhe Luksemburgu), që pranuan sepse ishin vende të vogla dhe lehtësisht të cënueshme, duke qenë se ishin pushtuar dy herë prej Gjermanisë, vareshin së tepërmi nga eksportet dhe e kuptuan se mënyra e vetme për të patur një zë të rëndësishëm në çështjet botërore dhe për të rritur nivelin e sigurisë ishte pjesëmarrja në një njësi rajonale më të madhe.

Qeveritë e tjera evropiane kishin arsye të ndryshme për të mos u bërë anëtare: Spanja dhe Portugalia ishin diktatura dhe nuk ishin shumë të interesuara për bashkëpunimin ndërkombëtar; në Danimarkë dhe Norvegji ishte ende shumë i freskët kujtimi i pushtimit gjerman; Austria, Suedia dhe Finlanda dëshironin të ruanin neutralitetin; Irlanda ishte një vend kryesisht bujqësor dhe shumë i lidhur ekonomikisht me Britaninë; kjo e fundit kishte akoma shumë interesa jashtë Evropës, eksportonte shumë pak prej çelikut të saj në Evropën perëndimore, ndërkohë që qeveria e re laburiste sapo i kishte vendosur në pronësi shtetërore industrinë e qymyrit dhe

çelikut dhe e shihte me antipati karakterin mbi-kombëtar të propozimit të Schuman-it.

Qeveritë e gjashtë vendeve – Franca, Gjermania Perëndimore, Italia, Holanda, Belgjika, dhe Luksemburgu – nisën negociatat dhe në 18 Prill 1951 nënshkruan Traktatin e Parisit, duke krijuar në këtë mënyrë Komunitetin Evropian të Qymyrit dhe Çelikut. Komuniteti qeverisesh prej Autoritetit të Lartë (në përbërje të tij ishin 9 anëtarë të emëruar dhe Jean Monnet ishte presidenti i parë i këtij autoriteti), ndërkohë që vendimet merreshin prej Këshillit Special të Ministrave (me 6 anëtarë). Asambleja e Përbashkët (78 anëtarë) e ndihmoi Monnet të qetësonte frikërat e qeverive kombëtare lidhur me dorëzimin pushtetit, ndërsa mosmarrëveshjet dhe konfliktet ndërmjet shteteve do të zgjidheshin prej Gjykatës së Drejtësisë (7 anëtarë).





KUR LINDI BASHKIMI EVROPIAN?

Shumë shpejt u bë e qartë se sektorët e qymyrit dhe çelikut, pavarësisht prej rezultateve të arritura, nuk mund të zhvilloheshin në izolim. Një takim i ministrave të jashtëm të vendeve të Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut në Mesina të Italisë në 1955 rezultoi në marrëveshjen për të rilançuar idenë evropiane. Ata miratuan një propozim të ardhur nga vendet e Beneluksit për të punuar për ngritjen e një Evrope të bashkuar nëpërmjet krijimit të institucioneve të përbashkëta, shkrirjes progresive të ekonomive kombëtare, vendosjes së një tregu të përbashkët, dhe harmonizimit progresiv të politikave sociale.

U ngrit një komitet që kryesohej prej ministrit të jashtëm belg Paul-Henri Spaak për të marrë në shqyrtim alternativat e propozuara. Raporti i komitetit bëri të mundur fillimin e një raundi negociatash dhe nënshkrimin në Mars 1957 të dy Traktateve të Romës, njëri prej të cilëve krijoi Komunitetin Ekonomik Evropian, ndërkohë që tjetri krijoi Komunitetin Evropian të Energjisë Atomike (Euroatom).

TOGETHER[®]
SINCE 1957

Logo që tregon datën e themelimit dhe moton e Bashkimit Evropian

Traktati i Komunitetit Ekonomik Evropian i angazhoi të gjashtë vendet për krijimin e një tregu të përbashkët brenda 12 vjetësh, duke

hequr gradualisht të gjitha kufizimet për tregëtinë ndërmjet tyre, duke vendosur tarifa doganore të përbashkëta për mallrat e ardhura nga jashtë Komunitetit, duke hequr barrierat e lëvizjes së lirë të njerëzve, shërbimeve dhe kapitalit ndërmjet shteteve anëtare, duke zhvilluar politika të përbashkëta bujqësore dhe transporti, dhe duke krijuar një Fond Social Evropian dhe një Bankë Evropiane Investimesh. Nga ana tjetër, Traktati i Euroatomit luajti një rol të vogël në procesin dhe integritimit dhe u fokusua kryesisht në kërkimin shkencor. Ajo që me të drejtë festohet si datëlindja e Bashkimit Evropian është pikërisht data e themelimit të Komunitetit Ekonomik Evropian.

5

CILAT JANË TRI SHTYLLAT MBI TË CILAT NGRIHET BASHKIMI EVROPIAN?

Bashkimi Evropian është i organizuar në mënyrë shumë komplekse dhe kështu që mund të konceptohet dhe kuptohet me shumë më tepër vështirësi se sa organizimi dhe funksionimi i shteteve kombëtare. Një perspektivë që lejon reduktimin e kompleksitetit të BE-së për një vëzhgues është përdorimi i skemës së tri shtyllave: (1) Komunitetet Evropiane; (2) Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët; (3) Bashkëpunimi Policor dhe Gjyqësor për Çështjet Penale. Kjo nuk është thjesht një skemë analitike, pra e shpikur prej një vëzhguesi për të lehtësuar procesin e vëzhgimit dhe studimit, por ekziston zyrtarisht në realitetin konkret të organizimit dhe funksionimit të Bashkimit Evropian.

Struktura e shtyllave e ka origjinën historike tek negociatat që sollën Traktatin e Maastrihit. Synimi ishte shtimi i pushtetit të Komunitetit në fushat e politikës së jashtme, sigurisë, mbrojtjes, azilit e migrimit, bashkëpunimit penal dhe atij gjyqësor. Megjithatë, disa prej shteteve anëtare e kundërshtuan shtimin e pushtetit të Komunitetit me arsyetimin se ata ishin shumë të ndjeshëm ndaj humbjes së sovranitetit kombëtar prej përdorimit të metodës komunitare dhe se çështje të tilla do të ishte më mirë të trajtoheshin nga dhe ndërmjet qeverive, kryesisht në kuadër të Bashkëpunimit Politik Evropian.



Francezët votojnë për Traktatin e Maastrihit të vitit 1993, i cili vendosi për krijimin e tri shtyllave të Bashkimit Evropian

Për pasojë, këto çështje nuk u përfshinë në Komunitetet Evropiane, por u vendos të trajtoheshin jashtë tyre (konkretisht prej qeverive të shteteve anëtare në Konferencat Ndër-qeveritare) në formën e dy shtyllave shtesë: Politika e Jashtme

dhe e Sigurisë së Përbashkët, dhe Drejtësia dhe Punët e Brendshme. Amendimet që pasuan me Traktatin e Amsterdimit dhe Traktatin e Nisës i kanë transformuar shtyllat gjithnjë e më tepër në mbi-kombëtare. Rëndësi të veçantë në këtë drejtim ka transferimi i politikave të azilit, migrimit, dhe bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile tek Shtylla e Komuniteteve Evropiane, gjë që u mundësua nga Traktati i Amsterdimit. Si rrjedhojë, shtylla e tretë është riemërtuar Bashkëpunimi Policor dhe Gjyqësor për Çështjet Penale. Megjithatë ende përdoret termi “Drejtësia dhe Punët e Brendshme” për t’iu referuar së bashku, shtyllës së tretë dhe fushave të transferuara.

Tabela e mëposhtme paraqet në detaje politikave që përbëjnë secilën prej shtyllave të Bashkimit Evropian.

Shtylla e parë Komunitetet Evropiane	Shtylla e dytë Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët	Shtylla e tretë Bashkëpunimi Policor dhe Gjyqësor për Çështjet Penale
<ul style="list-style-type: none"> • Bashkimi Doganor dhe Tregu Unik • Politika Bujqësore e Përbashkët <ul style="list-style-type: none"> • Politika e Përbashkët për Peshkimin • E Drejta Evropiane për Konkurrencën • Bashkimi Ekonomik e Monetar • Shtetësia Evropiane • Arsimi dhe Kultura <ul style="list-style-type: none"> • Rrjetet Tej-Evropiane • Mbrojtja e Konsumatorit • Kujdesi Shëndetësor <ul style="list-style-type: none"> • Kërkimi Shkencor • E Drejta për Mjedisin <ul style="list-style-type: none"> • Politikave Sociale • Politikave të Azilit • Traktati i Shengenit 	<ul style="list-style-type: none"> • Politika e Jashtme • Të Drejtat e Njeriut <ul style="list-style-type: none"> • Demokracia • Ndihma e huaj • Politika e Sigurisë • Politika Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes • Grupet e Luftimit të BE-së • Forca Evropiane e Reagimit të Shpejtë • Ruajtja e Paqes 	<ul style="list-style-type: none"> • Trafikimi i Drogës dhe Kontrabanda e Armëve <ul style="list-style-type: none"> • Terrorizmi • Trafikimi i Qenieve Njerëzore • Krimi i Organizuar <ul style="list-style-type: none"> • Ryshfeti dhe Mashtrimi

Shtylla e parë: Komunitetet Evropiane

Shtylla e parë përbëhet nga tre Komunitetet Evropiane: (a) Komuniteti Evropian; (b) Komuniteti Evropian i Qymyrit dhe Çelikut; (c) Euroatomi. Me themelimin e Bashkimit Evropian, Komuniteti Ekonomik Evropian u emërtua Komuniteti Evropian. Ky ndryshim synonte të shprehte kalimin prej një komuniteti me karakter tërësisht ekonomik drejt një bashkimi politik. Përfshirja e të tre komuniteteve në një shtyllë të vetme, megjithatë, nuk do të thotë se ato janë të unifikuara.

Shtylla e parë përfaqëson të drejtën komunitare në formën e saj më të lartë. Brenda kuadrit të Komunitetit Evropian institucionet komunitare (si p.sh. Komisioni dhe Parlamenti Evropian) mund të hartojnë normat komunitare në fushat përkatëse të veprimtarisë së tyre, të cilat zbatohen direkt mbi shtetet anëtare dhe gëzojnë superioritet ndaj së drejtës së brendshme të shteteve. Vend mjaft të rëndësishëm në Komunitetin Evropian zë tregu unik me katër liritë themelore të tij – liria e lëvizjes së personave, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit – si dhe rregullat për konkurrencën.

Shtylla e dytë: Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët

Përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Bashkimit Evropian, bashkëpunimi politik ndërmjet shteteve rregullohej nga marrëveshjet e vitit 1970 “Mbi Bashkëpunimin Politik Evropian” dhe nga Akti Unik Evropian. Këto marrëveshje parashikonin konsultime të rregullta ndërmjet ministrave të jashtëm të shteteve anëtare dhe kontakte të vazhdueshme ndërmjet departamenteve qeveritare. Megjithatë, të gjitha vendimet merreshin me unanimitet. Përsa u përket çështjeve të sigurisë, bashkëpunimi kufizohej vetëm në aspektet politike dhe financiare. Por krizat ndërkombëtare të viteve '90 (Lufta e Gjirit Persik dhe Lufta në ish- Jugosllavi) demonstuan se këto instrumenta të politikës së jashtme nuk ishin në gjendje t'i siguronin Bashkimit Evropian ndikimin e duhur në arenën ndërkombëtare.

Me Traktatin e Bashkimit Evropian, kryetarët e shteteve dhe qeverive ranë dakord të zhvillonin një politikë të jashtme dhe të sigurisë së përbashkët. Pjesa më e madhe e vendimeve në

kuadër të kësaj politike merren ende nëpërmjet bashkëpunimit të shteteve. Megjithatë, janë parashikuar një sërë instrumentash të rinj si pozicionet e përbashkëta, masat dhe veprimet e përbashkëta, dhe vendimet kuadër.

Shtylla e tretë: Bashkëpunimi Policor dhe Gjyqësor për Çështjet Penale

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve gjyqësore dhe policore të shteteve anëtare synon t'u ofrojë shtetasve të Bashkimit Evropian liri, siguri dhe drejtësi, duke parandaluar dhe luftuar bashkërisht krimin, racizmin dhe ksenofobinë. Bashkëpunimi gjyqësor trajton gjithashtu lehtësimin dhe përsheptimin e bashkëpunimit në fushën e zbatimit të vendimeve penale, lehtësimin e ekstradimit ndërmjet shteteve anëtare, vendosjen e normave penale uniforme në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikut të drogës.

Ashtu si dhe në rastin e Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët, Bashkëpunimi Policor dhe Gjyqësor për Çështjet Penale zhvillohet jashtë kuadrit vendim-marrës të Komunitetit Evropian. Megjithatë, institucioni deri tani më i rëndësishëm mbi-kombëtar (thënë ndryshe komunitar), Komisioni Evropian, mund të paraqesë propozime p.sh. në formë programi edhe për çështje të tilla që dalin jashtë fuqisë vendim-marrëse të Komunitetit.

6

KUSH E MBRON INTERESIN E PËRBASHKËT NË BASHKIMIN EVROPIAN?

Detyrën për të mbrojtur interesin e përbashkët të të gjitha shteteve anëtare të Bashkimit Evropian e ka Komisioni Evropian. Është pikërisht Komisioni që kujdeset për arritjen e zgjidhjeve të qëndrueshme në kohë dhe që marrin parasysh interesin e përbashkët. Por, për të kryer këtë funksion, Komisioni Evropian duhet të bashkëpunojë me institucionet e tjera të BE-së.

Emërimi dhe përbërja

Secili vend anëtar zgjedh një kandidat për postin e komisionerit në Kolegjin e komisionerëve. Pra Komisioni Evropian në BE-në me 27 shtete anëtare ka 27 komisionerë dhe një President të Komisionit. Kolegji i komisionerëve ka një mandat 5-vjeçar, por duhet të paraqitet për t'u dëgjuar para Parlamentit Evropian dhe të miratohet prej tij. Në rast se njëri prej komisionerëve kontestohet nga Parlamenti, ky është një mosmiratim i Kolegjit në tërësinë e vet, që sjell nevojën për të paraqitur nga e para për miratim gjithë Kolegjin e komisionerëve. Në përgjithësi qeveritë emërojnë në Komisionin Evropian politikanë të lartë, jo ekstremistë, dhe me prirje pro-evropiane.



Selia e Komisionit Evropian në Bruksel

Secilit komisioner i caktohet një portofol, pra një fushë përgjegjësie. Komisionerët kanë kabinate personale për t'i asistuar në punën e tyre. Poshtë nivelit të komisionerëve shtrihet burokracia e Komisionit me rreth 22 mijë të punësuar.

Organizimi

Njësitë organizative më të rëndësishme të Komisionit janë Drejtoritë e Përgjithshme, të cilat janë përgjegjëse për mbarëvajtjen e fushave të veçanta të politikave, ashtu si ministritë në shtetet kombëtare. Përveç tyre funksionojnë edhe shërbime të tjera, të cilat mund të krahasohen në rastin e Shqipërisë me rolin e institucioneve të pavarura.

Në Komision ekziston një hierarki si vijon:

- Të gjitha çështjet e rëndësishme kanalizohen nëpërmjet takimeve javore të Kolegjit të Komisionerëve. Në këto takime vendimet merren me unanimitet kur është e mundur, por edhe me shumicë votash kur është e nevojshme.
- Në fushat e veçanta të politikave Komisioneri që ka portofolin mban përgjegjësinë kryesore të lidërshiptit.
- Drejtoritë e Përgjithshme kryesohen zyrtarisht nga Drejtorët e Përgjithshëm, që janë përgjegjës ndaj Komisionerit apo Komisionerëve përkatës.
- Drejtoritë kryesohen nga Drejtorët, të cilët i raportojnë Drejtorit të Përgjithshëm.
- Njësitë kryesohen nga Kryetarët e Njësive, të cilët i raportojnë Drejtorit përkatës.



Presidenti i Komisionit Evropian, Hose Manuel Barroso dhe kancelari austriak Wolfgang Schlüssel në një ndeshje bamirësie

Përgjegjësitë dhe kompetencat

Komisioni Evropian ka përgjegjësi dhe kompetenca që burojnë nga traktatet e BE-së, por edhe të tjera që kanë lindur nga nevojat praktike dhe kërkesat e sistemit të Bashkimit Evropian. Ndër to më të rëndësishmet janë: propozimi dhe zhvillimi i politikave dhe legjislacionit, funksionet ekzekutive (vendosja e rregullave, menaxhimi i financave të BE-së, mbikëqyrja e

zbatimit të politikave, dhe rregullimet në përshtatje me procedurat ose thënë ndryshe 'komitologjia'), mbrojtja e kuadrit ligjor nga deformimet dhe shkeljet (p.sh. kur ndonjë shtet anëtar nuk respekton të drejtën e BE-së, kur kompanitë shkelin të drejtën e BE-së për praktikën kufizuese, ose kur kompanitë shkelin rregullat e BE-së për ndihmën shtetërore), përfaqësimi dhe negociimi në emër të BE-së me pjesën tjetër të botës, ndërmjetësimi dhe pajtimi në rastin e konflikteve, dhe promovimi i interesit të përgjithshëm evropian.






KUSH E PËRFAQËSON ZËRIN E SHTETEVE ANËTARE TË BE-SË?

Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian përfaqësohen në Këshillin e Ministrave dhe në Këshillin Evropian. Duhet patur kujdes për të dalluar këto dy institucione prej Këshillit të Evropës, i cili nuk është pjesë e Bashkimit Evropian.

Këshilli i Ministrave

Përgjegjësitë dhe funksionet

Përgjegjësia kryesore e Këshillit të Ministrave (ose shkurtimisht Këshillit) është të marrë vendime për politikën dhe legjislacionin. Sigurisht që edhe Komisioni dhe Parlamenti



Karikaturë e interesit kombëtar kundrejt interesit të përbashkët evropian

Evropian disponojnë kompetenca të tilla, por ato janë të pakrahasueshme me pushtetin e Këshillit. Bashkëpunimi i Këshillit me Komisionin dhe Parlamentin Evropian dhe varësia e tij prej tyre varion në lidhje me llojin e vendimeve që duhen marrë. Në përgjithësi Këshilli ka më shumë hapësirë për vendimmarrje në shtyllën 2 dhe 3 të BE-së, duke qenë se këto janë ndërqeveritare, ndërkohë që në shtyllën 1 (Komunitetet Evropiane) Këshilli mund të marrë vendime, por vetëm pasi Komisioni Evropian të ketë bërë një propozim.

Në shtyllën 1 të BE-së Këshilli i Ministrave është veçanërisht i kufizuar në rolin e vendimmarrësit kur shtrohet çështja e prodhimit të legjislacionit. Së pari, siç u përmend dhe më sipër, Këshilli nuk mund të fillojë veprimtarinë e tij po të mos ketë një propozim paraprak nga ana e Komisionit. Së dyti, reformat e traktateve të BE-së varen mjaft prej Parlamentit Evropian, duke e shndërruar këtë të fundit në një aktor shumë të rëndësishëm. Procedura e bashkë-vendimmarrjes (*co-decision procedure*) që aplikohet në BE ka krijuar dy legjislatorë, Këshillin dhe Parlamentin Evropian. Megjithatë, do të ishte e parakohëshme dhe e përgënjeshtuar nga praktika të thuhej

se rolin e iniciuesit të politikave e ka vetëm Komisioni dhe se Këshilli varet krejtësisht prej veprimeve nismëtare të Komisionit Evropian. Në fakt ka referenca ligjore (p.sh. Neni 208 i Traktatit të Komunitetit Evropian) që krijojnë hapësirat e nevojshme për Këshillin që të jetë iniciues i politikave ose të anashkalojë Komisionin në këtë pikë.

Përbërja

Samiti Evropian i Seviljes e reduktoi numrin e llojeve të këshillit nga 16 në 9. Kështu janë këshillat e mëposhtëm: (1) Çështjet e Përgjithshme dhe Marrëdhëniet me Jashtë; (2) Çështjet Ekonomike dhe Financiare; (3) Drejtësia dhe Punët e Brendshme; (4) Çështjet e Punësimit, Politikave Sociale, Shëndetit dhe Konsumatorit; (5) Konkurrueshmëria (Tregu i Brendshëm, Industria dhe Kërkimi Shkencor); (6) Transporti, Telekomunikacioni dhe Energjia; (7) Bujqësia dhe Peshkimi; (8) Mjedesi; dhe (9) Arsimi, Rinia dhe Kultura. Në secilin prej këshillave të mësipërm marrin pjesë ministrat përkatës të ve anëtare të Bashkimit Evropian, si ata të Punëve të Jashtme, Ekonomisë, Financës etj. Për t'u përmendur janë edhe COREPER (Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm), që funksionon si mbështetje teknike për punën e Këshillit, dhe Sekretariati Përgjithshëm, që mbështet punën e Këshillit në aspektin administrativ. Sekretariati i Përgjithshëm kryesohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit, i cili vepron gjithashtu edhe si Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë e Përbashkët.



Në qendër Presidentja e Këshillit të Bashkimit Evropian, Angela Merkel, djathtas në fotografi Presidenti i Komisionit Evropian, Hose Manuel Barroso

Funksionimi i Këshillit

Një institucion i rëndësishëm është Presidenca e Këshillit. Drejtimi i këtij institucioni bëhet me rotacion nga secili prej

shteteve anëtare çdo gjashtë muaj. Presidenca e Këshillit (duke bashkëpunuar me Sekretariatit e Përgjithshëm) organizon dhe drejton shumicën e takimeve të Këshillit, përpiqet të arrijë konsensus për iniciativat që ndërmerren, siguron vazhdimësi dhe konsistencë në zhvillimin e politikave, dhe përfaqëson Këshillin në takimet dhe negociatat me institucionet e tjera.

Këshilli funksionon në bazë të një strukture hierarkike. Në shkallën më të lartë të hierarkisë janë ministrat, më poshtë është COREPER, dhe në fund janë komitetet dhe grupe pune të ndryshme. Pra një propozim i Komisionit Evropian për Këshillin kalon nga grupi i punës tek përfaqësuesit e përhershëm (COREPER) dhe në fund tek ministrat, të cilët marrin vendim të prerë.

Sipas traktateve Këshilli ka në dispozicion tri mënyra për të arritur tek marrja e një vendimi: votim unanim, shumicë të cilësuar, dhe shumicë të thjeshtë votash. *Unanimiteti* përdoret nga Këshilli në rastet kur trajtohen çështje të Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët, Bashkëpunimit Policor dhe Gjqësor, çështje kushtetuese, dhe çështje financiare. Po ashtu votimi unanim kërkohet kur Këshilli dëshiron të ndryshojë një propozim të Komisionit kundër dëshirës së këtij të fundit. *Shumica e cilësuar* përdoret në shumicën e vendimeve që i përkasin shtyllës së parë (Komuniteteve Evropiane), dhe një pjesë të vogël të dy shtyllave të tjera. Që një vendim të merret nëpërmjet shumicës së cilësuar duhet që rreth 2/3 e shteteve anëtare të votojnë pro tij. *Shumica e thjeshtë* përdoret vetëm në rastet e procedurave dhe tarifave antidumping dhe kundër subvencionimit. Në këtë mënyrë votimi secili prej shteteve anëtare ka një votë në dispozicion, në dallim prej shumicës së cilësuar.

Këshilli Evropian

Anëtarësia

Në Traktatin e Bashkimit Evropian shprehet qartë se janë dy nivele pjesëmarrjeje në Këshillin Evropian: (1) Kryetarët e Shteteve dhe Qeverive të shteteve anëtare dhe Presidenti i Komisionit; (2) Ministrat e Jashtëm të shteteve anëtare dhe një anëtar i Komisionit, që ndjekin samitin për të ofruar asistencën e tyre. Megjithatë në samite mund të marrin pjesë edhe përkthyesit, gjashtë zyrtarë (dy nga vendi që ka

Presidencën e rradhës, një nga Sekretariati i Këshillit, dhe tre nga Komisioni), si dhe një nëpunës civil i secilit shtet anëtar, i cili mund të zëvendësohet kurdo që shihet e nevojshme prej dikujt tjetër nga delegacioni i shtetit.

Organizimi

Këshilli Evropian është i detyruar të mbledhet të paktën dy herë në vit. Këto dy takime të detyrueshme ndodhin në përfundim të mandatit të Presidencës së Këshillit të secilit shtet anëtar, pra në qershor dhe dhjetor. Por praktika ka treguar se Këshilli Evropian zakonisht mbledhet më shumë se dy herë në vit, për të trajtuar çështje që kërkojnë zgjidhje të shpejtë.

Çdo vend që mban Presidencën e Këshillit ka detyrimin që njërin prej samiteve ta organizojë në Bruksel. Zakonisht takimet e Këshillit Evropian zgjasin një ditë. Për përgatitjen e samiteve rol të rëndësishëm kanë kryetari i shtetit që mban Presidencën e rradhës, liderë të tjerë të shteteve anëtare, dhe ministrat e jashtëm. Janë këta aktorë që në përgjithësi influencojnë përmbajtjen e axhendës së samitit.

Rolet dhe Aktivitetet

Temat dhe fushat kryesore që trajton Këshilli Evropian janë pesë: (1) Evoluimi i Bashkimit Evropian – veçanërisht

reforma kushtetuese dhe institucionale, Bashkimi Ekonomik dhe Monetar, dhe zgjerimi; (2) Çështjet kushtetuese dhe institucionale – vendimet lidhur me anëtarësimet e reja në BE, çështje institucionale specifike, emërime personeli të rëndësishme, konstitucionalizimi/ formalizimi i integritetit evropian; (3) Politikat ekonomike dhe monetare të BE-së; (4) Marrëdhëniet me jashtë; dhe (5) Çështje specifike të politikave të brendshme – që janë politika me ndjeshmëri të lartë dhe kërkojnë një vizion të gjerë dhe gjithëpërfshirës.



Në të djathtë Javier Solana, Përfaqësuesi i Lartë i BE-së



SI PËRFAQËSOHEN QYTETARËT NË BASHKIMIN EVROPIAN?

Parlamenti Evropian, i zgjedhur nëpërmjet votës së qytetarëve evropianë, kryen funksionin e përfaqësimit të zërit qytetar në procesin e vendim-marrjes së BE-së. Siç shihet, në Bashkimin Evropian bëhet dallimi ndërmjet interesit kombëtar (të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave dhe Këshilli Evropian) dhe interesit të përbashkët (të përfaqësuar nga Komisioni Evropian) nga njëra anë, dhe interesit të qytetarëve evropianë, nga ana tjetër.

Kompetencat dhe influenca

Parlamenti Evropian (shkurtimisht Parlamenti) ka një influencë jo të vogël në BE, të cilën e ushtron nëpërmjet procesit legjislativ, procesit buxhetor, dhe kontrollit e mbikëqyrjes së ekzekutivit. Parlamenti mund të influencojë legjislacionin e BE-së në një sërë rastesh: (1) Parlamenti shpesh merr pjesë në diskutimet e politikave së bashku me Komisionin në fazën legjislative të para-propozimit; (2) Parlamenti mund të miratojë



Seancë e Parlamentit Evropian

zyrtarisht idetë e veta për legjislacionin në fjalë (raporte iniciues ose ide për legjislacionin); (3) Cikli buxhetor vjetor krijon mundësi që Parlamenti të ushtrojë influencë legjislative; (4) Parlamenti mund të influencojë në mënyrë indirekte programin legjislativ vjetor të Komisionit – ky program diskutohet nga komitetet parlamentare në prani të përfaqësuesve të Komisionit Evropian dhe votohet nga Parlamenti; (5) Parlamenti ka në dispozicion 4 procedura për të marrë në shqyrtim legjislacionin e rëndësishëm të BE-së: *procedura e konsultimit* (Parlamentit i kërkohet mendim në lidhje me propozimet

legjislative të Komisionit); *procedura e bashkëpunimit* (pasi Këshilli i Ministrave ka marrë një pozicion të përbashkët lidhur me propozimin e Komisionit, duhet të japë arsyet për këtë pozicion të ndërmarrë para Parlamentit dhe të miratohet prej këtij të fundit me shumicë absolute votash, gjë që referohet edhe si “leximi i dytë”); *procedura e bashkë-vendimmarrjes* (në rast se Parlamenti dhe Këshilli arrijnë marrëveshje për propozimin e Komisionit gjatë “leximit të parë”, propozimi miratohet që në këtë fazë, në të kundërt ngrihet një komitet pajtimi kur Parlamenti e ndryshon propozimin me shumicë absolute votash. Nëse komiteti i pajtimit që përbëhet nga një numër i barabartë anëtarësh prej Këshillit dhe Parlamentit nuk arrin në marrëveshje të përbashkët, propozimi bie); *procedura e miratimit* (Parlamenti i merr në konsideratë propozimet gjatë një leximi të vetëm dhe nuk mund të bëjë ndryshime, por mund të vendosë veton).

Në lidhje me procesin buxhetor të BE-së Parlamenti mund të propozojë ndryshime për shpenzimet e detyrueshme (kryesisht në bujqësi), mund të propozojë ndryshime për shpenzimet jo të detyrueshme (shumica e fushave përveç bujqësisë) dhe, duke dhënë arsyet për këtë mund të kundërshtojë projekt-buxhetin e paraqitur dhe të kërkojë një të ri.

Roli kontrollues dhe mbikqyrës i Parlamentit Evropian është më i vështirë për t’u luajtur në krahasim me atë që luajnë parlamentet kombëtare për dy arsye: së pari, organizimi i BE-së është shumë kompleks për të mundur të përcaktohet qartë përgjegjësia e zbatimit korrekt të politikave; dhe së dyti, për çështje me diapazon të gjerë është e vështirë të dallohet ndarja e roleve ndërmjet Komisionit, Këshillit të Ministrave dhe Këshillit Evropian. Pavarësisht këtyre vështirësive, Parlamenti p.sh. ka në dispozicion 8 kompetenca për të kontrolluar dhe mbikqyrur veprimtarinë e Komisionit: (1) Kandidati për President i Komisionit Evropian miratohet nga Parlamenti; (2) I gjithë Kolegji i Komisionerëve të propozuar duhet të miratohet nga Parlamenti; (3) Parlamenti mund ta shkarkojë Kolegjin me dy të tretat e votave, por nuk mund të shkarkojë një Komisioner të vetëm; (4) Diskuton në seancë të hapur raportin e përgjithshëm vjetor të dërguar nga Komisioni; (5) Komisioni dërgon çdo vit në Parlament (dhe Këshill) të dhënat

e vitit financiar të kaluar në lidhje me zbatimin e buxhetit; (6) Komitetet e përhershme parlamentare mund të ushtrojnë në çdo kohë funksionin mbikëqyrës; (7) Parlamenti mund të krijojë komitete të përkohëshme hetimore; (8) Parlamenti mund t'i drejttojë pyetje Komisionit. Në lidhje me Këshillin e Ministrave dhe Këshillin Evropian roli kontrollues dhe mbikëqyrës i Parlamentit është shumë i kufizuar.

Përbërja

Të gjitha shtetet anëtare të BE-së, në një raport të caktuar sipas popullsisë që kanë, zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Parlamentin Evropian. Vendi që ka më shumë përfaqësues është Gjermania, dhe më pas vijnë Britania e Madhe, Franca dhe Italia. Aktiviteti i partive politike ndodh në tri nivele në lidhje me Parlamentin Evropian: niveli tej-kombëtar (*transnational*), grupet politike në Parlamentin Evropian, dhe niveli kombëtar. Federatat tej-kombëtare janë formuar rreth parimeve të përgjithshme dhe ekzistojnë për synime koordinimi, propagandimi dhe elektorale. Tri janë federatat në Parlamentin Evropian: Partia e Popullit Evropian, e përbërë nga parti



Selia e Parlamentit Evropian në Bruksel

të qendrës së djathtë, Partia Liberale, Demokratike dhe Reformatore Evropiane, dhe Partia e Socialistëve Evropianë.

Aktiviteti politik në Parlamentin Evropian kanalizohet kryesisht nëpërmjet grupeve politike, që duhet të kenë minimalisht 14 anëtarë. Janë 8 grupe të tilla: Grupi i Partisë së Popullit Evropian dhe Demokratëve Evropianë, Grupi i Partisë së Socialistëve Evropianë, Grupi i Partisë Liberale, Demokratike dhe Reformatore Evropiane, Grupi i Të Gjëlberve, Grupi Konfederal i Së Majtës Evropiane, Grupi i

Bashkimit për Evropën e Kombeve, Grupi për një Evropë të Demokracive dhe Diversiteteve, dhe Grupi Teknik (ku bëjnë pjesë parlamentarët që nuk dëshirojnë të bashkohen me grupet e tjera).

Partitë politike kombëtare përfshihen në aktivitetet që lidhen me Parlamentin Evropian në tri mënyra kryesore: (1) shumica e kandidatëve në zgjedhjet për Parlamentin Evropian zgjidhen nga partitë kombëtare; (2) fushatat për zgjedhjet në Parlamentin Evropian janë në thelb fushata që drejtohen nga partitë kombëtare; dhe (3) në Parlamentin Evropian ekzistojnë grupe të partive kombëtare brenda grupeve politike.



9

KUSH GARANTON PAPREKSHMËRINË E RREGULLAVE TË “LOJËS” NË BE?

Ky është funksioni i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Është ky institucion që ndërhyr në rastet kur raportohet se është shkelur e drejta e Bashkimit Evropian, d.m.th. traktatet, direktivat, vendimet, rregulloret etj.

Anëtarësia dhe organizimi

Gjykata Evropiane e Drejtësisë është në Luksemburg dhe nuk duhet të ngatërrohet me Gjykatën Evropiane për Të Drejtat e Njeriut që ndodhet në Strasburg. Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka në përbërje të saj nga një gjykatës prej secilit shtet anëtar. Gjykatësit caktohen për një mandat 6-vjeçar, por që është i rinovueshëm dhe për caktimin e tyre duhet të që gjitha

qeveritë e shteteve anëtare të BE-së të bien dakord. Gjyqtarët zgjedhin Presidentin e Gjykatës që e kryen këtë rol për një periudhë 3-vjeçare. Tetë avokatë të përgjithshëm (secili prej tyre ka dy sekretarë ligjorë) ndihmojnë gjyqtarët në ushtrimin e detyrave të tyre. Gjykata punëson edhe një staf prej rreth 1100 personash që përfshihen në kryerjen e detyrave administrative.



Logo e Gjykatës
Evropiane të
Drejtësisë

Llojet e çështjeve që paraqiten në Gjykatë

Gjykata nuk mund të fillojë vetë veprimet. Ajo duhet të presë që çështjet

t'i adresohen. Kjo mund të ndodhë në një sërë mënyrash, ku më të rëndësishmet janë si vijon:

- kur nuk plotësohet një detyrim ligjor i parashikuar në traktatet e BE-së nga ana e shteteve anëtare;
- kur bëhet aplikim për anulim të veprimeve të ndërmarra nga institucionet e BE-së;
- në rast mosveprimi të institucioneve të BE-së dhe shteteve anëtare që shkelin të drejtat e personave fizikë ose juridikë;
- kur ka një veprim për vendosur se kush është përgjegjës për dëmet e kryera;

- kur Gjykatës i drejtohen për të interpretuar çështje që të mundësojë marrjen e vendimit nga ana e gjykatave kombëtare;
- kur çështja që apeloher del jashtë juridiksionit të Gjykatës së Shkallës së Parë (një tjetër institucion i BE-së);
- kur janë shkelur rregullat proceduriale, ose është shkelur e drejta komunitare;
- kur Gjykatës i kërkohet mendim nga Këshilli, Komisioni ose një shtet anëtar nëse një marrëveshje e ardhshme ndërkombëtare është apo jo në përputhje me dispozitat e traktateve të BE-së.



Seancë e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë

10

ÇFARË ËSHTË INTEGRIMI EVROPIAN?

Për të kuptuar integrimin evropian është e nevojshme të kuptohet fillimisht se çfarë do të thotë “integrim”. Le të mendojmë diçka të përbërë nga pjesë, p.sh. një institucion. Pjesët e institucionit janë sektorët që e përbëjnë atë. Këta sektorë quhen të integruar, atëherë kur efektet që prodhohen tek njëri sektor ndikojnë në funksionimin e sektorëve të tjerë. Integrimi, ashtu si dhe efektet, mund të jetë pozitiv ose negativ, por është e rëndësishme të kuptohet që mbi të gjitha, integrim do të thotë që pjesët e ndryshme nuk mund të jenë më të izoluar, krejtësisht të pavarura dhe indiferente. Në një kuptim më të afërt me ndjeshmëritë njerëzore, integrim do të thotë solidaritet: do të thotë gëzim i përbashkët dhe hidhërim i përbashkët.

Por çfarë është integrimi evropian? Në rastin e integritit evropian pjesët që integrohen janë shtetet kombëtare. Ajo që shtetet kombëtare humbasin gjatë procesit të inte-



Presidenti i Komisionit Evropian, Barroso, dhe Komisioneri Evropian për Zgjerimin, Olli Rehn, duke zbuluar hartën e BE-së me 27 shtete anëtare

grimit evropian është sovraniteti, që do të thotë se për një numër të konsiderueshëm çështjesh vendimet nuk mund të merren më prej qeverive të shteteve kombëtare, por prej institucioneve të Bashkimit Evropian. Ndërsa ajo që shtetet kombëtare fitojnë gjatë integritit evropian është solidariteti, i kuptuar si treg i përbashkët, mbrojtje e përbashkët, monedhë e përbashkët, politikë bujqësore e përbashkët etj.

Nga ana tjetër, solidariteti që rrjedh prej integritit evropian bazohet në disa vlera themelore të përbashkëta, të cilat duhet

t'i respektojnë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe ato vende që dëshirojnë të anëtarësohen në të. Këto vlera shpesh grupohen në të ashtuquajturat kritere, si më poshtë:

Kriteri politik:

Demokracia, Shteti i së drejtës, Mbrojtja e të drejtave të njeriut, Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të minoriteve

Kriteri ekonomik:

Ekonomi tregu funksionale, e aftë të përballojë presionet konkurruese dhe forcat e tregut të BE-së

Kriteri administrativ

Aftësia për të përballuar detyrimet e anëtarësimit në Bashkimin Evropian

Kriteri politik thekson faktin që të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian funksionojnë mbi bazën e demokracisë liberale, shteti i së drejtës është i konsoliduar, të gjithë janë të barabartë para ligjit, të drejtat e njeriut janë të shenjta dhe minoritetet nuk i nënshtrohen diskriminimit. Përqaftimi i këtyre vlerave është vendimtar dhe themelor për vendet që kërkojnë të anëtarësohen në Bashkimin Evropian. Në këto rrethana, një pjesë e konsiderueshme e ndihmës së BE-së për Shqipërinë synon pikërisht ndërtimin dhe aplikimin e këtyre vlerave.

Kriteri ekonomik synon të trajtojë çështjen e integritimit ekonomik në Bashkimin Evropian. Shqipëria, p.sh. duhet të forcojë ekonominë e vet, duhet të fusë teknologji të avancuara dhe të sigurojë se produktet dhe shërbimet shqiptare janë të standardeve dhe cilësisë së lartë, që nuk janë të dëmshme për konsumatorët, në mënyrë që të bëhet i mundur përballimi i konkurrencës me ekonomitë e shteteve anëtare të BE-së.

Kriteri administrativ nënvizon nevojën e adoptimit (miratimit dhe zbatimit) të legjislacionit të Bashkimit Evropian në kuadrin ligjor të shtetit shqiptar. Për këtë nuk është thjesht e nevojshme që Parlamenti shqiptar të miratojë traktatat, direktivat, vendimet, rregulloret dhe akte të tjera ligjore të BE-së si pjesë e legjislacionit tonë, por në të njëjtën kohë Shqipëria duhet të forcojë administratën shtetërore për të bërë të mundur zbatimin e legjislacionit të ri.

11

ÇFARË ËSHTË MARRËVESHJA E STABILIZIM-ASOCIMIT?

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) është një marrëveshje ligjore ndërkombëtare ndërmjet vendit nënshkrues (në rastin tonë Shqipërisë) dhe Bashkimit Evropian. Funkzioni i saj është të vendosë kuadrin ligjor për bashkëpunim ndërmjet të dy palëve dhe adoptimin gradual të standardeve evropiane, të tilla si kushtet që duhet të plotësojnë mallrat, shërbimet dhe kapitalet shqiptare që të mund të lëvizin lirisht në Bashkimin Evropian, apo rregullat që përcaktojnë se si duhet të zhvillohet konkurrenca në treg.

Një nga karakteristikat kryesore të MSA-së është përqendrimi në krijimin dhe forcimin e parimeve demokratike dhe bashkëpunimit me vendet e rajonit të Ballkanit. Bashkëpunimi rajonal synon vendosjen e një rrjeti marrëveshjesh dy dhe shumëpalëshe ndërmjet vendeve të Ballkanit në fushën tregtare, ekonomike, ligjore, politike etj. Kjo qasje ka për qëllim krijimin dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet vendeve ballkanike, duke sjellë frymën e bashkëpunimit dhe pajtimit, për të mënjanuar tensionet dhe nxitur zhvillimin reciprok.

Përfitimet më të rëndësishme, të drejtpërdrejta nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit janë në fushën e tregtisë, duke lejuar një hyrje më të lirë të prodhimeve vendase në tregun e përbashkët evropian. Me përmirësimin e kushteve të eksportit lindin mundësi të shumta për zhvillimin e



Ceremonia e nënshkrimit të MSA-së në Bruksel më 12 qershor 2006

kompanive shqiptare dhe të ekonomisë kombëtare në përgjithësi.

Nga ana tjetër, Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit mundëson një hyrje më të lehtë të mallrave europiane për blerësit dhe konsumatorët shqiptarë, përmes procedurave administrative më të shkurtra, më efikase dhe me çmime më të ulta.

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit gjithashtu krijon mundësinë e marrjes së burimeve financiare prej fondeve të ndryshme strukturore të Bashkimit Evropian, si dhe të ndihmës për ndërtimin e kapaciteteve institucionale, zhvillimin rajonal dhe pjesëmarrjen në mjaft projekte të BE-së, si p.sh. programet e shkëmbimit për profesorët dhe studentët, ose bashkëpunim midis qendrave të kërkimit në Shqipëri me ato të BE-së.



12**SI ËSHTË NDËRTUAR MARRËVESHJA E STABILIZIM-ASOCIIMIT?**

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është e ndarë në tituj, kapituj dhe nene, përmbajtjen e të cilave do ta përshkruajmë shkurtimisht më poshtë, duke ndjekur një strukturë të ngjashme me atë të MSA-së.

Dialogu politik

Në kuadër të dialogut politik Shqipëria duhet të përshtasë qëndrimet e saj në politikën e jashtme me ato të diplomacisë së Bashkimit Evropian, duke humbur në këtë mënyrë një pjesë të sovranitetit të vet.

Bashkëpunimi rajonal

Bashkëpunimi rajonal është një nga kapitujt më të rëndësishëm të MSA-së dhe synon ta integrojë Shqipërinë sa më tepër në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë. Ky është një proces që përfshin të gjitha fushat e bashkëpunimit, që nga ai politik e ekonomik, deri tek bashkëpunimi institucional, social e kulturor. Shqipëria duhet të zhvillojë bashkëpunimin rajonal me vendet që kanë nënshkruar Marrëveshje Stabilizim-Asociimi, vendet e tjera të Procesit të Stabilizim-Asociimit dhe vendet kandidatë për anëtarësim në BE. Nëpërmjet bashkëpunimit rajonal synohet të krijohet një zonë stabiliteti dhe zhvillimi ekonomik në rajonin e Ballkanit. Në të njëjtën kohë bashkëpunimi rajonal paraqet një shans për forcimin e rolit të Shqipërisë në rajon dhe më gjerë si një partner i besueshëm në marrëdhëniet politike dhe tregtare.

Hapja e tregut

Shqipëria dhe Komuniteti Evropian do të hapin tregun ndërmjet tyre, gjë që do të thotë se ato do të heqin detyrimet doganore, kufizimet sasiore dhe masat e tjera që kanë këtë efekt për mallrat që do të eksportohen nga Shqipëria në Komunitetin Evropian dhe anasjelltas. Nga ana tjetër, Palët nuk do të marrin masa për mbrojtjen e produkteve kombëtare në tregtinë që do të zhvillojnë ndërmjet tyre. Gjithashtu ndalohet vendosja e detyrimeve të reja doganore për importet ose eksportet, si dhe e kufizimeve të reja sasiore, duke synuar ruajtjen e nivelit ekzistues të hapjes së tregut ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian. Hapja e tregut ka edhe

elementë të tjerë përveç lëvizjes së lirë të mallrave; që të sigurohet efektshëria e kësaj të fundit parashikohet gjithashtu liria e shqiptarëve (dhe evropianëve anasjelltas) për të ofruar shërbime, për të lëvizur lirisht kapitalin e tyre, për t'u vendosur dhe për të lëvizur lirisht në territorin e Komunitetit Evropian. Por këto liri jepen kundrejt plotësimit të një sërë kushteve nga ana e Shqipërisë.

Çështje ligjore

Këto janë çështje që lidhen me hapat që duhet të ndërmarrë Shqipëria drejt plotësimit të njërit prej kritereve të Kopenhagenit (është fjala për kriteret që duhet të plotësojë një shtet për t'u bërë anëtar i Bashkimit Evropian; këto kritere u shpallën në Samitin e Kopenhagenit të vitit 1993): përfshirja e legjislacionit të Bashkimit Evropian në korpusin ligjor të



| Konferencë e organizuar në Tiranë me rastin e një vjetorit të nënshkrimit të MSA-së

Shqipërisë dhe zbatimi i tij. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit nuk e vendos Shqipërinë menjëherë përpara këtij detyrimi, por kërkon që Shqipëria të hedhë hapat e nevojshëm për t'u përgatitur për përfshirjen e plotë dhe zbatimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian. Kështu Shqipërisë fillimisht i kërkohet të përafrojë legjislacionin e saj me atë të Bashkimit Evropian në disa fusha të rëndësishme për funksionimin e tregut dhe shtetit ligjor.

Drejtësia, liria dhe siguria

Në këtë fushë të Marrëveshjes Shqipëria duhet të bashkëpunojë me Bashkimin Evropian për të forcuar institucionet e saj në të gjitha nivelet, por në veçanti ato institucione që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit dhe administrimin e drejtësisë. Bashkëpunimi ndërmjet Palëve synon fuqizimin, pavarësinë dhe efektshmërinë e funksionimit të sistemit gjyqësor dhe strukturave të tjera përgjegjëse për vendosjen dhe respektimin e shtetit ligjor. Bashkëpunimi në fushën e Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë do të mbështetet në dy shtylla kryesore. Shtylla e parë lidhet me bashkëpunimin në fushën e lëvizjes së lirë të personave dhe parashikon një sërë dispozitash për vizat, azilin, migracionin, menaxhimin e kufirit dhe politika të tjera që kanë të bëjnë me lëvizjen e lirë të njerëzve. Shtylla e dytë lidhet me bashkëpunimin në luftën kundër fenomeneve të krimit të organizuar, terrorizmit, pastrimit të parave dhe drogave të paligjshme dhe parashikon dispozita sipas të cilave Shqipëria dhe Bashkimi Evropian do të angazhojnë strukturat e tyre policore dhe gjyqësore në një luftë të përbashkët kundër fenomeneve të lartpërmendura.

Politikat sektoriale

Politikat sektoriale përfshijnë një numër të madh fushash, disa prej të cilave janë me rëndësi strategjike për Shqipërinë, si: transporti, energjia, bankat, turizmi, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme etj. Shqipëria do të përfitojë asistencë për ristrukturimin dhe rimëkëmbjen e këtyre sektorëve. Megjithatë, asistenca e Bashkimit Evropian nuk do të thotë investime direkte në sektorët e lartpërmendur, por do të jetë e përqendruar në forcimin e kapaciteteve dhe ngritjen e strukturave të nevojshme për zhvillimin me efikasitet të politikave sektoriale.

Asistenca financiare

Bashkimi Evropian, në kuadër të politikave për t'u zgjeruar duke përfshirë vendet në lindje të kontinentit evropian, ka patur një angazhim konkret në Ballkanin Perëndimor që prej vitit 1991. Programet e ndihmës për Shqipërinë kanë qenë PHARE dhe CARDS. Këto programe kanë synuar të ndihmojnë Shqipërinë për të përparuar në procesin e Integrimit Evropian, duke u përqendruar (sidomos programi CARDS) tek rindërtimi i vendit, zhvillimi dhe stabilizimi i

arritjeve në planin politik, ligjor dhe ekonomik. Programi i ri i asistencës së Bashkimit Evropian për Shqipërinë quhet IPA (Instrumenti i Para-anëtarësimit). Ky program i ri asistence do të marrë në konsideratë ndryshimet e ndodhura në ekonominë dhe shoqërinë shqiptare, si dhe fazën e tanishme të marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian. Nëpërmjet IPA-s Bashkimi Evropian do ta ndihmojë Shqipërinë të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.



13

KUR MUND TË ANËTARËSOHET SHQIPËRIA NË BASHKIMIN EVROPIAN?

Procesi i integritimit evropian mund të ndahet në një numër fazash, të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme. Shqipërisë do t'i duhet të kalojë nëpër të gjitha këto faza që të mund të anëtarësohet në Bashkimin Evropian. Në tabelë paraqitet kohëzgjatja minimale dhe maksimale për secilën nga fazat.

Faza e emërtuar *Opinion* i referohet vlerësimit që i bëhet aplikimit të një vendi për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, nga ana e Komisionit Evropian mbi bazën e Përgjigjeve të një Pyetësori të përgatitur nga Komisioni. Ndërsa faza e emërtuar *Hyrja në fuqi e MSA* i referohet



Pasaporta evropiane që përdoret në Mbretërinë e Bashkuar

Fillimi i Negociatave të MSA	Janar 2003
Nënshkrimi i MSA	Qershor 2006
Hyrja në Fuqi e MSA	1-4 vjet
Opinion	1-3 vjet
Fillimi i Negociatave të Anëtarësimit	1-7 vjet
Nënshkrimi i Traktatit të Anëtarësimit	2 muaj-5 vjet
Data e Anëtarësimit	1-2 vjet

ratifikimit (miratimit) të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit nga parlamentet e të gjitha shteteve anëtare të BE-së.

Deri tani Shqipëria ka përshkuar 2 prej 7 fazave që duhen kaluar për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Shqipëria ka arritur të fillojë negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit në janar 2003 dhe të nënshkruajë këtë Marrëveshje me Komunitetin Evropian në qershor 2006, tri vjet pas hapjes së negociatave. Shqipërisë i mbetet të kalojë edhe 5 etapa të tjera deri në anëtarësimin e saj në BE. Duke u nisur prej fazës së tanishme dhe rasteve të vendeve të tjera që kanë kaluar procesin e Integritimit Evropian, anëtarësimi i Shqipërisë në BE mund të ndodhë pas 4 – 21 vjetësh, në periudhën nga viti 2010 deri në vitin 2027.

14

CILAT JANË SFIDAT QË DUHET TË PËRBALLOJË SHQIPËRIA NË KUADËR TË PROCESIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN?

Procesi i Integrimit Evropian, krahas përfitimeve ka dhe një sërë kostosh për vendin. Me fjalë të tjera, për të arritur tek përfitimet Shqipërisë do t'i duhet të përballojë sfidën që vjen prej kostove të procesit të Integrimit. Janë disa sfidat me të cilat duhet të ndeshet kryesisht qeveria dhe shteti shqiptar, por edhe aktorë të tjerë jashtë strukturave shtetërore të interesuar për mbarëvajtjen e procesit të Integrimit.

Forcimi i administratës publike

Administrata publike ka rol thelbësor në procesin e Integrimit Evropian të vendit. Është administrata publike që ka detyrën të vërë në zbatim angazhimet që ndërmerret qeveria shqiptare në kuadër të këtij procesi. Problemet me të cilat është ndeshur administrata publike gjatë viteve të tranzicionit kanë qenë të shumta: ato kanë variuar nga rekrutimi i nëpunësve të administratës mbi baza lidhjesh nepotike e politike, arbitrariteti i lëvizjeve dhe pushimeve nga vendi i punës, mungesa e praktikave të punës dhe logjistikës së nevojshme, tek trajnimet e pamjaftueshme, puna e dobët që kryhet nga strukturat monitoruese të punonjësve të administratës, pagat e ulëta dhe mungesa në përgjithësi e motivimit të nëpunësve civilë.

Kjo gjendje e administratës publike është vënë në dukje edhe nga Komisioni Evropian në raportet monitoruese për Shqipërinë. Në veçanti Komisioni Evropian është treguar mjaft skeptik në lidhje me aftësitë e administratës publike të Shqipërisë për të zbatuar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Kjo ka qenë njëra prej arsyeve kryesore për shtyrjen kaq të gjatë të nënshkrimit të MSA-së. Detyrimet e Shqipërisë të parashikuara në MSA do të shoqërohen me fonde të mëdha në kuadër të programeve të asistencës komunitare. Kjo do të thotë se sa më shumë të përparojë Shqipëria në procesin e Integrimit, aq më e madhe do të jetë ndihma financiare e Komunitetit Evropian. Nga ana tjetër, duke qenë se fenomeni i korrupsionit nuk është një rast i veçantë në administratën publike shqiptare, por përkundrazi ndeshet shpesh dhe në

përmasa të gjera, është e natyrshme që Brukseli nuk dëshiron që paratë e ardhura prej taksave të qytetarëve evropianë të pasurojnë në mënyrë të paligjshme disa njerëz në Shqipëri. Pa një administratë publike të aftë të kuptojë proceset integruese dhe me vullnetin e ndërgjegjën e duhur profesionale, procesi i Integritimit të Shqipërisë në BE nuk mund të përparojë.

Reforma fiskale

Shqipëria është një vend në të cilin të ardhurat nga tarifatat doganore mbi produktet e importit zënë një përqindje shumë të lartë në buxhetin e shtetit krahasuar me shtetet anëtare të BE-së apo dhe me vende të tjera të rajonit të Ballkanit. Në Slloveni dhe Bullgari të ardhurat buxhetore nga doganat përbëjnë përkatësisht 0.6 dhe 0.7 përqind të Prodhimit të Brendshëm Bruto, ndërkohë që në Shqipëri përbëjnë rreth 2 përqind. MSA parashikon reduktimin gradual të tarifave doganore mbi produktet e importit deri në heqjen e plotë të doganave në vitin e dhjetë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes. Kjo do të thotë që në buxhetin e shtetit do të hyjnë gjithnjë e më pak të ardhura nga doganat, deri sa ky kontribut të bëhet zero. Vendet e përmendura më sipër, si Sllovenia dhe Bullgaria, e kanë patur më të lehtë procesin e reduktimit të tarifave doganore. Kontributi i doganave në buxhetin e shtetit në këto vende nuk ka qenë aq i madh sa në Shqipëri – kështu që dhe reforma fiskale mund të kryhej më me lehtësi.

Në rastin e Shqipërisë reforma fiskale është e vështirë. Thënë ndryshe, për shkak të strukturës së ekonomisë shqiptare, ajo do të ketë një kosto më të madhe. Vendi bosh që do të mbetet në arkën e shtetit nga heqja e të ardhurave doganore do të duhet të mbushet me taksa të tjera, jo vetëm për të kompesuar humbjen e këtij burimi të ardhurash, por më tepër për të arritur një konsolidim fiskal të vendit, për të rritur nivelet e investimeve publike dhe për të bërë të mundur zbatimin e strategjive kombëtare për zhvillimin ekonomik e social. Sfida në këtë rast qëndron në atë se sa do të mundet qeveria shqiptare ta zëvendësojë kontributin e doganave me të ardhura të tjera dhe nëse ky zëvendësim të ardhurash do të shkaktojë rënie ekonomike në përgjithësi, apo do të dëmtojë rëndë kategori të caktuara të shoqërisë.

Ngritja e një ekonomie konkurruese tregu

Angazhimet e Shqipërisë në kuadër të MSA-së, dhe veçanërisht angazhimi për të krijuar një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian, bëjnë që fati i komunitetit të biznesit shqiptar të jetë i lidhur ngushtë me atë të ekonomisë së vendit. Deri tani kompanitë shqiptare nuk e kanë ndjerë shumë presionin e konkurrencës. Edhe hyrja në fuqi e marrëveshjeve të tregtisë së lirë me vendet e rajonit të Ballkanit, pavarësisht zhurmës mediatike, nuk solli humbje të rënda për biznesin vendas. Kjo gjë nuk ndodhi, për arsyen e thjeshtë se volumi tregtar i Shqipërisë me këto vende është shumë i vogël.

Megjithatë, tregtia e lirë me Bashkimin Evropian pritet të ketë impakt tjetër, duke marrë parasysh se BE është partneri kryesor tregtar i Shqipërisë. Në rast se deri tani, në

kuadër të Regjimit Asimetrik Preferencial Tregtar, produktet shqiptare gëzojnë trajtim të privilegjuar, që deri diku i mbron nga konkurrenca e produkteve evropiane, me shfuqizimin e regjimit asimetrik dhe



Sfidat e integrimit evropian

vendosjen e regjimit simetrik tregtar ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian, përballë konkurrencës së lirë produktet shqiptare do të mund t'i mbrojnë vetëm cilësia e tyre. Fitimet dhe humbjet e komunitetit të biznesit do të varen nga cilësia e produkteve që do të ofrojnë në treg. Me fjalë të tjera, ekonomia shqiptare duhet të orientohet dhe strukturohet në mënyrë të tillë që të mund të realizojë produkte cilësore dhe konkurruese.

Për të kapërcyer sfidën e konkurrencës së lirë ekonomia shqiptare duhet të orientohet drejt atyre produkteve ku Shqipëria ka disa avantazhe krahasuese në raport me vendet e BE-së. Në këtë kuadër rëndësi të dorës së parë merr reformimi dhe subvencionimi i sektorëve strategjikë të ekonomisë. Gjithashtu është mjaft e rëndësishme të përmirësohet mjedisi i biznesit, duke hequr pengesat e panevojshme dhe të tejzgjatura burokratike, si dhe duke futur një regjim tatimesh më stimulues për këtë komunitet. Këto megjithatë nuk mjaftojnë. Elemente mjaft të rëndësishme të tregtisë me BE-në janë edhe standardizimi dhe çertifikimi i produkteve. Në këtë fushë Shqipëria është mjaft mbrapa dhe për pasojë, shumë pak prej produkteve shqiptare mund të hyjnë në tregun evropian. Sfida konturohet si vijon: A do të jetë në gjendje qeveria shqiptare të orientojë ekonominë drejt sektorëve ku Shqipëria gëzon avantazhe relative në raport me BE-në; a do të mund qeveria të përmirësojë mjedisin ku operon biznesi shqiptar; dhe a do të realizohet në masën dhe kohën e duhur standardizimi dhe çertifikimi i produkteve shqiptare?

Përafrimi i legjislacionit

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë evropian është detyrë parësore e Shqipërisë. Nuk është thjesht fakti se Brukseli e ka shtruar këtë kërkesë, që duhet ta shtyjë qeverinë shqiptare të marrë masa për ta realizuar këtë proces. Rëndësia e përafrimit të legjislacionit shihet më tepër po të analizohet në kuadër të konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare në tregun evropian. Siç thamë më sipër, që produktet shqiptare të jenë konkurruese në tregun evropian, ato kanë nevojë të standardizohen dhe çertifikohen. Për standardizimin dhe çertifikimin e produkteve ka mijëra faqe të së drejtës evropiane, me të cilat duhet të përafrohen ligjet dhe aktet e tjera nënligjore të shtetit shqiptar. Përafrimi i legjislacionit është thelbësor për zhvillimin e ekonomisë shqiptare dhe përfitimin nga hapësirat që lejojnë marrëveshjet e nënshkuara ndërmjet Shqipërisë dhe KE-së.

Përveç kostove financiare të mëdha, ekspertizës dhe koordinimit të mirë të punës për përkthimin dhe përafrimin e legjislacionit, ky proces mund të shtrojë edhe një sfidë tjetër: atë të mospërputhjes së nevojave konkrete të Shqipërisë me “zgjidhjet” që propozohen prej legjislacionit evropian. Për të

dhënë vetëm një shembull, në legjislacionin evropian ka mijëra faqe për standardet mjedisore, gjë që implikon se Shqipërisë do t'i duhet të vendosë dhe respektojë standarde shumë herë më të larta për mbrojtjen e mjedisit se ato që zbatohen momentalisht. Në mënyrë të pashmangshme kjo do të rrisë koston për hapjen dhe mbajtjen e biznesit dhe mund të dekurajojë zhvillimin e një sërë biznesesh. Nga ana tjetër, Shqipëria është një vend me papunësi të lartë dhe për të zgjidhur këtë problem, pra për të hapur vende të reja pune, ka nevojë për zhvillim të konsiderueshëm të biznesit. Qeverisë shqiptare do t'i duhet që, nga njëra anë të respektojë kërkesat e Brukselit, por nga ana tjetër të adresojë nevojat e ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare, dhe për këtë duhet të hartojë një axhendë të vetën, brenda lirisë së veprimit që lejohet nga Komuniteti Evropian.



15

SI MUND TË SHPJEGOHET INTEGRIMI EVROPIAN?

Teoritë e integrimit evropian mbështeten në disa koncepte të cilat do t'i përkufizojmë duke iu përmbajtur përdorimit të tyre në këto teori, dhe jo kuptimit që u jepet në fusha të tjera studimi. Për më tepër, janë pikërisht konceptet e mëposhtme ato tek të cilat përqendrohet debati ndërmjet atyre që e praktikojnë integrimin dhe atyre që e vëzhgojnë atë nga pozicioni i studiuesit.

Sovraniteti – kapaciteti ligjor i vendim-marrësve kombëtarë për të marrë vendime, pa iu nënshtruar kufizimeve nga jashtë. Zakonisht ky quhet sovranitet kombëtar dhe ndonjëherë sovranitet shtetëror. **Ndër-qeveritarizmi** – i referohet ujdive nëpërmjet të cilave shtetet kombëtare, në situata dhe kushte të kontrollueshme prej tyre, bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për çështje me interes të përbashkët. Ekzistenca e kontrollit, që i lejon të gjitha shtetet pjesëmarrëse të vendosin për nivelin dhe natyrën e këtij bashkëpunimi, dëshmon që sovraniteti kombëtar nuk dëmtohet drejtpërsëdrejti (pra jo në mënyrë lineare, por komplekse). **Mbi-kombëtarizmi** – shtetet bashkëpunojnë në një mënyrë që nuk i lejon të ruajnë kontroll të plotë mbi zhvillimet konkrete. Me fjalë të tjera, shtetet mund të jenë të detyruar të veprojnë kundër preferencave dhe vullnetit të tyre, sepse nuk e kanë pushtetin për të ndaluar vendimet. Në këtë mënyrë, mbi-kombëtarizmi i vendos marrëdhëniet ndër-shtetërore përtej bashkëpunimit dhe drejt integrimit, dhe gjithashtu nënkupton një lloj humbjeje të sovranitetit kombëtar.

Studiuesit e integrimit evropian kanë eksploruar një sërë mënyrash se si mund të konceptohet teorikisht procesi i integrimit. Synimi i këtij eksplorimi është zhvillimi i të kuptuarit për faktorët mbi të cilët mbështetet integrimi evropian dhe në këtë mënyrë mundësimi i parashikimeve për rrugën që mund të ndjekë integrimi në të ardhmen.

Neofunksionalizmi

Bazat e neofunksionalizmit u hodhën në fund të viteve '50 dhe gjatë viteve '60 të shekullit XX veçanërisht prej studiuesve

të tillë si Ernst Haas (Ernst Has) dhe Leon Lindberg (Leon Lindberg). Në formulimin klasik neofunksionalizmi ka në qendër të tij konceptin e *spillover*-it. Për të kuptuar këtë koncept mund të përdoret një metaforë. Të mendojmë sikur hedhim një sasi të caktuar uji në një sipërfaqe të kufizuar në formën e labirintit. Uji do të kalojë nga kanali ku e hedhim tek kanalet e tjerë, për t'u përhapur në të gjithë sipërfaqen. Koncepti i *spillover*-it shfaqet në dy forma: *spillover* funksional dhe *spillover* politik.

Spillover-i funksional i përshkruan ekonomitë moderne si të ndërlidhura me njëra-tjetrën, gjë që e bën të vështirë kufizimin e integritimit vetëm në sektorë ekonomikë të veçantë. Në këtë mënyrë, integrimi në një sektor të ekonomisë prodhon presion për integrim në sektorë fqinjë dhe sektorë të lidhur me të parin.

Spillover-i politik rrjedh prej integritimit ekonomik dhe ndjek hapat e mëposhtme: (a) elitat kombëtare i kushtojnë gjithnjë e më shumë vëmendje nivelit mbi-kombëtar të aktiviteteve dhe vendim-marrjes; (b) këto elita pozicionohen në favor të procesit të integritimit dhe promovimit të interesave të përbashkëta; (c) institucionet mbi-kombëtare dhe aktorët jo-qeveritarë bëhen më të rëndësishëm në procesin e integritimit, ndërkohë që bie influenca e shteteve kombëtare dhe aktorëve qeveritarë; (d) rritja e rëndësisë së integritimit gjeneron presion dhe kërkesa për kontroll politik dhe llogaridhënie në nivelin mbi-kombëtar.



Glob me simbolet e Bashkimit Evropian

Neofunksionalizmi i hershëm sugjeroi një zhvillim progresiv të integritimit evropian. Integrimi pritej të sillte integrim të mëtejshëm. Megjithatë, kriza ekonomike në fillim të viteve '70 që goditi edhe Europën i ndaloj iniciativat integruese. Megjithë integrimin e shpejtë të politikave dhe karakterin mbi-kombëtar të sjelljes politike dhe vendim-marrjes, integrimi i politikave nuk u zhvillua ashtu siç pritej, ndërkohë që sjellja politike dhe vendim-marrja mbetën thelbësisht të bazuara dhe

të kushtëzuara prej interesave kombëtare. Neofunksionalistët e pranuan që teoria e integritimit evropian duhet t'i kushtonte më shumë vëmendje, ndër të tjera, nacionalizmit dhe rolit të lidhshpimit politik – koncepte që nuk trajtoheshin në teoritë e Haas dhe Lindberg.

Hapi i integritimit u përshpejtua përsëri në fund të viteve '80. Në të njëjtën kohë studiues si Jeppe Tranholm-Mikkelsen (Jeppe Tranholm-Mikkelsen) argumentuan se pjesa më e madhe e kësaj dinamike të re integrimi mund të shpjegohej prej perspektivës neofunksionaliste. Tranholm-Mikkelsen demonstroi ekzistencën e *spillover*-it funksional në rastin e Tregut Unik Evropian, ku kushtet fillestare për përfundimin e tregut të brendshëm u shtrinë gradualisht për të përfshirë, ndër të tjera, dimensionin social, monedhën e përbashkët dhe një masë për harmonizimin fiskal. Në lidhje me *spillover*-in politik ai argumentoi se përparimet e mëdha në vendim-marrjen mbi-kombëtare që prej mesit të viteve '80, me rolin e 'motorrit' caktuar Komisionit Evropian, përdorimin e shpeshtë të shumicës së cilësuar në Këshill, dhe mbështetjes së shumë prej aktiviteve integruese prej Gjykatës Europiane të Drejtësisë, mund të shpjegohen brenda kuadrit të teorisë neofunksionaliste.

Ndër-qeveritarizmi

Kjo teori e shpjegon drejtimin dhe ritmin e procesit të integritimit kryesisht duke iu referuar vendimeve dhe veprimeve të qeverive të shteteve evropiane. Ndër-qeveritarizmi pranon që aktorë të tjerë, si brenda ashtu dhe jashtë shteteve, mund të influencojnë zhvillimet, por kjo influencë nuk është vendimtare dhe aq më pak kontrolluese. Fokusimi në perceptimin e shteteve që kanë interesa kombëtarë të ndryshëm dhe që i mbrojnë ato me forcë, si p.sh. në politikën e jashtme, sigurinë dhe mbrojtjen, ka sjellë si rezultat që teoria ndër-qeveritare të vërë theksin tek 'logjika e diversitetit' në vend të 'logjikës së integritimit'.

Një autor i shquar i ndër-qeveritarizmit është Andreë Moravcsik (Endrju Moravçik), i cili e emërton qasjen e vet ndër-qeveritarizëm liberal. Kjo qasje ka tre komponentë kryesorë. (1) Supozohet se shteti sillet në mënyrë racionale, që do të thotë se veprimet e shteteve mbështeten në

shfrytëzimin e atyre mjeteve që vlerësohet se janë më të përshtatshme për të arritur qëllimet; (2) Qëllimet shtetërore mund të marrin formë nga presionet dhe ndërveprimet brenda shtetit, ndërkohë që këto të fundit shpesh janë të kushtëzuara prej detyrimeve dhe mundësive që rrjedhin nga ndërvarësia ekonomike; (3) Marrëdhëniet ndërmjet shteteve interpretohen si marrëdhënie ndërmjet qeverive, dhe janë qeveritë ato që kanë një rol në përcaktimin e marrëdhënieve ndërmjet shteteve dhe, për më tepër, rezultati i negociatave midis qeverive është thelbësisht i përcaktuar prej fuqive negociuese relative dhe avantazheve që rrjedhin prej kryerjes së marrëveshjeve.

Ndërvarësia

Ndërkohë që neofunksionalizmi dhe ndër-qeveritarizmi pranojnë që faktorët e jashtëm kanë influencuar ritmin dhe karakterin e integrimit evropian, të dyja këto teori trajtojnë kryesisht dinamikën e brendshme të integrimit. Në të kundërt, ndërvarësia është përdorur nga studiuesit e integrimit evropian për ta vendosur integrimin në një kontekst më të gjerë të karakterizuar prej rritjes së ndërvarësisë ndërkombëtare.

Teoria e ndërvarësisë filloi të zhvillohej në vitet '70, veçanërisht prej Robert Keohane (Robert Kiohejn) dhe Joseph Nye (Xhozef Naj). Sipas kësaj teorie procesi i integrimit nuk duhet të shihet në një kontekst shumë të ngushtë. Modernizimi ndërkombëtar pas Luftës së Dytë Botërore në format e tij të ndryshme (nivelet e pasurisë, rritja e madhe e tregëtisë botërore, revolucioni teknologjik dhe transformimi i komunikimeve) ka promovuar forma të ndryshme të ndërvarësisë politike dhe ekonomike. Për pasojë, këto kanë sjellë transformimin e mënyrave të përdorura nga pjesë të ndryshme të botës për t'u lidhur dhe kontaktuar me njëra-tjetrën. Për shembull ka patur një rritje të vazhdueshme të numrit dhe shumëllojshmërisë së aktorëve ndërkombëtarë – si sipër ashtu dhe poshtë nivelit të shteteve kombëtare – që korrespondon me një dobësim të dominimit të shteteve. Një gamë në rritje metodash dhe kanalesh përdoren prej aktorëve ndërkombëtarë për të realizuar qëllimet e tyre, ndërkohë që marrëdhëniet ndërmjet qeverive nuk kontrollohen më aq shumë nga kancelaritë dhe ministritë e punëve të jashtme. Gama e çështjeve në axhendat ndërkombëtare është zgjeruar veçanërisht me çështje që lidhen

me sigurinë dhe mbrojtjen (çështje të politikës 'së lartë'), por edhe me çështje që lidhen me pasurinë dhe mirëqënien (çështje të politikës 'së ulët'). Paralelisht me ndryshimin e përmbajtjes së axhendave politike ndërkombëtare, të paktën në botën e industrializuar perëndimore, vërehet një përdorim më i rrallë i forcës si instrument i politikave, ndërkohë që konfliktet për disbalancat e tregëtisë dhe kursin e shkëmbimit të parasë nuk zgjidhen me armë por nëpërmjet negociimit, rregullimit dhe kompromisit.

Në këtë mënyrë, teoria e ndërvarësisë e vendos integrimin evropian në një kontekst ndryshimesh të shpejta që përdodhin në të gjithë sistemin ndërkombëtar. Ky sistem po bëhet, ashtu si dhe vetë sistemi i BE-së, gjithmonë e më tepër me shumë nivele dhe i ndërlidhur. Teoria e ndërvarësisë ndryshon prej neofunksionalizmit dhe ndër-qeveritarizmit sepse ajo thekson se shumë aspekte të procesit të integritit evropian shpjegohen prej faktorëve global dhe sepse thekson gjithashtu që shumë nga karakteristikat sistemike të Bashkimit Evropian ndeshen edhe në sistemin ndërkombëtar, edhe pse me intensitet më të ulët.